



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

PËR: Deputetët e Kuvendit
Cc: Kryesinë e Kuvendit

NGA: Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

LËNDA: Raport me rekomandim, në lidhje me Projektligjin nr. 08/L-140 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të Ujërave të zeza në Mitrovicë

Datë: 06.04.2022.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të nenit 60 dhe nenit 69, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 06.04.2022, shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-140 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të Ujërave të zeza në Mitrovicë dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projektligji nr. 08/L-140 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të Ujërave të zeza në Mitrovicë.
2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Armend Muja, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafit 1.4 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve, me ligj Ratifikon Marrëveshjet Ndërkombëtare për marrjen e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur më 06.04.2022, pasi shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-140 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e trajtimit të Ujërave të zeza në Mitrovicë, vlerësoi se ky Projektligj ka objektiv kryesor

ndërtimin e impiantit të ri të trajtimit të ujërave të zeza, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit në Komunën e Mitrovicës dhe Vushtrisë dhe lidhjen e komuniteteve fqinje. Projekti përfshin dy financues: Bankën Evropiane për Investime dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim kap vlerën prej 13,500,000 euro, në kuadër të këtij projekti është edhe një grant nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Përendimor në vlerë prej 5,000,000 euro, për shpenzime kapitale, andaj Komisioni i rekomandon Kuvendit ratifikimin e kësaj marrëveshje.

**Kryetari i Komisionit,
Armend Muja**